



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 399/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2017 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Anulimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë”.

Ankimues: “Boshnjaku B” shpk
Rr. “Skenderbeu” L. “Bishanak” Pranë Karburant “Bolv Oil”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Korçë
Rruga “28 Nëntori”, Korçë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.10.2016, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 07.11.2016, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët pas korrigjimit të ofertave nga autoriteti kontraktor, rezultojnë se kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k.
& “Kthella” sh.p.k. 73.154.761 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Elira” sh.p.k.
& “Beladi” sh.p.k. 74.390.011 lekë, skualifikuar
3. “Boshnjaku B” sh.p.k. 75.737.090 lekë, kualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xhengo” sh.p.k.
& “G.P.G. Company” sh.p.k. 87.120.120 lekë, skualifikuar

- | | |
|---|-----------------------------------|
| 5. “Pienvis” sh.p.k. | 88.518.492 lekë, skualifikuar |
| 6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” sh.p.k.
& “Agri Konstruksion” sh.p.k. | 90.000.000 lekë, skualifikuar |
| 7. “Alko Impex General Construction” d.sh.h. | 92.192.075 lekë, kualifikuar |
| 8. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Glavenica” sh.p.k.
& “Ngracan” sh.p.k. & “Dajti Park” sh.p.k. | 93.773.232 lekë, skualifikuar |
| 9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndregjoni” sh.p.k.
& “Vllaznia Ndërtim IS” sh.p.k. | 98.959.712 lekë, skualifikuar |
| 10. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ad - Star” sh.p.k.
& “Murati” sh.p.k. | 96.410.610 lekë, skualifikuar |
| 11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” sh.p.k.
& “Everest” sh.p.k. | 100.986.324 lekë, skualifikuar |
| 12. “Aurora Konstruksion” sh.p.k. | 97.212.851 lekë, skualifikuar |
| 13. “Junik Konstruksion” sh.p.k. | 104.500.542 lekë, kualifikuar |
| 14. Subjekti fizik “Syrja Bame” | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 21.12.2016 operatori bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” shpk & “Kthella” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi.

II.4. Në datën 27.12.2016 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” shpk & “Kthella” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

II.5. Në datën 05.01.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 6798/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 13.01.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” shpk & “Kthella” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 236/1 prot., datë 23.01.2017, të protokolluar me tonën në datën 27.01.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” shpk & “Kthella” shpk.

II.8. Në datën 06.03.2017 pas shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 105/2017 datë 06.03.2017 ku vendosi:

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “Kthella” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.*
4. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.9. Në datën 29.03.2017 me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës për anulimin e procedurës së prokurimit me arsyetimin se “Autoriteti kontraktor Bashkia Korçë njofton se procedura e prokurimit me objekt “Qendra e Kreativitetit” e zhvilluar në datë 07.11.2016 anulohet bazuar në nenin 24 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.”

II.10. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative, KPP konstaton se në datën 29.03.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1429 protokollit ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues për anulimin e procedurës së prokurimit me argumentin se “ Autoriteti kontraktor Bashkia Korçë ju njofton se ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit me objekt “Qendra e Kreativitetit” e zhvilluar në datën 07.11.2016. Anullimi është bërë bazuar në nenin 24 pika 1.a të ligjit n.r9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik; Bazuar në nenin 24 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit” ju bëjmë me dije se: në kushtet kur në objektin ku ishe parashikuar të ndërhyej aktualisht ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre institucioni I prefektit të qarkut Korçë dhe Këshilli i Qarkut Korçë ishte menduar që këto dy institucione të zhvendosesin në ambjentet e shtëpisë së oficerave, objekt ky i cili ishte në pronësi të Bashkisë Korçë. Nga Këshilli i Bashkisë Korçë nuk u miratuar dhënia e ambjenteve të ëmsh shtëpisë së oficerave institucionit të Prefektit dhe Këshillit të Qarkut. Gjithashtu me VKM nr.193 datë 15.03.2017 është vendosur revokimi i të drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës në emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” Duke qenë se veprimtaria e institucioni i prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk mund të ndërpiertet dhe në kushtet kur nuk ka ambiente të përshtatshme për zhvendosjen e tyre, investimi në këtë objekt është i pamundur të kryhet.

II.11. Në datat 03.04.2017 dhe 04.04.2017 operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.11.1 Referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur operatori ekonomik ankimues ngre pretendimet se: “Anullimi i procedurave të prokurimit është një veprim që është përdorur gjerësisht nga autoriteti kontraktor para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra në ligjin 131/2012. Shumë autoritete kontraktor anullonin procedurat e prokurimit, pa patur argumente të mbështetura në ligj duke përfutuar nga përkufizimi i përgjithshëm që i bëhej termit “interes publik” Omissis... Për fat të gjithë operatorëve

ekonomikë konkurues të ndershëm dhe taksa pagues të rregullt ky përkufizim i nenit 24 u ndryshua me ligjin nr.131/2014 sipas parashimeve legislative aktualisht në fuqi:

1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;

b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;

c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negocim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;

ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;

d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;

dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve dhe përkufizimeve të reja, ligjvënësi ka patur për qëllim të kufizoj sa më shumë abuzimet e mundshme nga ana e autoriteteve kontraktore. Në nenin 24 të LPP-së janë specifikuar qartësisht rastet e anulimit të një procedure prokurimi dhe singërisht, me gjithë mirëkuptimin dhe vullnetin e mirë nga ana jonë për ta marrë të mirëqënë arsyetimin e dhënë në vendimin për anulimin të kësaj procedure prokurimi, ky shkak/arsyetim është i pa argumentuar dhe i pallogjikshëm dhe në kundërshtim flagrant me ligjin. Madje dhe vetë ju si autoritet kontraktor nuk jeni të qartë në arsyen e vërtetë të anulimit të kësaj procedure prokurimi, duke mos dhënë asnjë arsye/argument konkret por duke u bazar thjeshtë në përkufizimin e gërmës “a” pika 1, neni 24 të LPP-së “Qendra e Kreativitetit” e zhvilluar në datën 07.11.2016 anulohet bazuar në nenin 24 pika 1.a të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Për më tepër që legjislacioni ifushës është ndryshuar posaçësisht për të mundësuar evitimin e abuzimeve të tilla. Në nenin 24, pika 1 gërma “a”, ligjvënësi shprehimisht ka parashikuar se një procedurë mund të anulohet për vetëm për ato shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit. Me shkresën nr.1429 prot datë 29.03.2017 arsyeja e pretenduar për anulimin e procedurës është “në kushtet kur në objektin ku ishe parashikuar të ndërhyej aktualisht ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre institucioni i prefektit të qarkut Korçë dhe Këshilli i Qarkut Korçë ishte menduar që këto dy institucione të zhvendosesin në ambientet e shtëpisë së oficerave, objekt ky i cili ishte në pronësi të Bashkisë Korçë. Nga Këshilli i Bashkisë Korçë nuk u miratuar dhënia e ambjentëve të ish shtëpisë së oficerave institucionit të Prefektit dhe Këshillit të Qarkut. Gjithashtu me VKM nr.193 datë 15.03.2017 është vendosur revokimi i të drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës në emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” Duke qenë se veprimtaria e institucioni i prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk mund të ndërpritet dhe në kushtet kur nuk ka ambiente të përshtatshme për zhvendosjen e tyre, investimi në këtë objekt është i pamundur të kryhet.” Mbështetur në dispozitat ligjore të parashikuara nga LPP-ja ku përcaktohet se procedura e prokurimit anulohet këto shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, arsyeja ku është mbështetur AK

për anulimin e procedurës së prokurimit përjashtohet dhe nuk është arsye e mbështetur në ligj për dy momente. Së pari gjetja e ambjeteve për ushtrimin e aktivitetit të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut nuk është shkak që është jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor. Për më tepër që marrje me qira e ambjeteve është procedurë e përjashtuar në bazë të germës a neni 7 të LPS-së për rrjedhje lehtësohet gjetja e vendit të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit të institucionit të prefektit të qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk është shkak i pa parashikueshëm në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit. Për këto arsye shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjetja e vendit për ushtrimin e aktivitetit normale të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë është një kusht tërësisht nën kontrollin e autoritetit kontraktor dhe i parashikueshëm në momentin e fillimit të procedurës së prokurimit. Për më tepër, në si ofertues që kemi përgatitur ofertën me vlerë më të ulët të kualifikuar jemi dakord që në kontratën e sipërmarrjes për këtë objekt të përcaktohet se punimet të fillojnë menjëherë pas lirimit të sheshit të ndërtimit. Pra nuk kemi pretendime për kohën e fillimit.”

II.12. Në datën 06.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 1423/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke mos e pranuar ankesën.

II.12.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

“Anullimi është bërë bazuar në nenin 24 pika 1.a të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik; Bazuar në nenin 24 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit” ju bëjmë me dije se: në kushtet kur në objektin ku ishe parashikuar të ndërhyej aktualisht ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre institucioni i prefektit të qarkut Korçë dhe Këshilli i Qarkut Korçë ishte menduar që këto dy institucione të zhvendosesin në ambjentet e shtëpisë së oficerave, objekt ky i cili ishte në pronësi të Bashkisë Korçë. Nga Këshilli i Bashkisë Korçë nuk u miratuar dhënia e ambjeteve t ëish shtëpisë së oficerave institucionit të Prefektit dhe Këshillit të Qarkut. Gjithashtu me VKM nr.193 datë 15.03.2017 është vendosur revokimi i të drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë të mjedisëve të katit të parë teknik, të pronës në emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” Duke qenë se veprimtaria e institucioni i prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk mund të ndërpritet dhe në kushtet kur nuk ka ambiente të përshtatshme për zhvendosjen e tyre, investimi në këtë objekt është i pamundur të kryhet.” Nga ana jonë nuk mund të parashikohej mosmiratimi nga Këshilli Bashkisë dhënia me huapërdorje e ambjeteve të ish shtëpisë së oficerave dhe aq më pak revokimi i të drejtës së pronësisë të këtij ambienti nga Këshilli i Ministrave. Lidhur me pretendimin se është shkaktuar dëm ekonomik sqarojmë se “bazuar në nenin 24 pika 2 të ligjit

nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni”

II.13. Në datën 13.04.2017 operatori ekonomik ankimues “Boshnjaku B” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.14 Njëpërmjet shkresës me nr. 1773/1 prot., datë 24.04.2017, të protokolluar me tonën në datën 02.03.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi me argumentin se *“Duke qenë se veprimtaria e institucioni i prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk mund të ndërpritet dhe në kushtet kur nuk ka ambiente të përshtatshme për zhvendosjen e tyre, investimi në këtë objekt është i pamundur të kryhet.”* Mbështetur në dispozitat ligjore të parashikuara nga LPP-ja ku përcaktohet se procedura e prokurimit anulohet këto shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, arsyetimi është mbështetur AK për anulimin e procedurës së prokurimit përjashtohet dhe nuk është arsye e mbështetur në ligj për dy momente. Së pari gjejtat e ambjeteve për ushtrimin e aktivitetit të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut nuk është shkak që është jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi duke njoftuar operatorët ekonomikë mbi vendimarrjen e tij me arsyetimin si më poshtë vijon *“Autoriteti kontraktor Bashkia Korçë ju njofton se ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit me objekt “Qendra e Kreativitetit” e zhvilluar në datën 07.11.2016. Anullimi është bërë bazuar në nenin 24 pika 1.a të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik; Bazuar në nenin 24 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se “Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u*

komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit” ju bëjmë me dije se: në kushtet kur në objektin ku ishe parashikuar të ndërhyej aktualisht ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre institucioni i prefektit të qarkut Korçë dhe Këshilli i Qarkut Korçë ishte menduar që këto dy institucione të zhvendosesin në ambjentet e shtëpisë së oficerave, objekt ky i cili ishte në pronësi të Bashkisë Korçë. Nga Këshilli i Bashkisë Korçë nuk u miratuar dhënia e ambjenteve të ëish shtëpisë së oficerave institucionit të Prefektit dhe Këshillit të Qarkut. Gjithashtu me VKM nr.193 datë 15.03.2017 është vendosur revokimi i të drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës në emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” Duke qenë se veprimtaria e institucioni i prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë nuk mund të ndërpritet dhe në kushtet kur nuk ka ambiente të përshtatshme për zhvendosjen e tyre, investimi në këtë objekt është i pamundur të kryhet.” Në mënyrë të përmbledhur, KPP vlerëson se argumentet e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi lidhet me faktin se në momentin e vendimarrjes së vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ndodhet në pamundësinë e gjetjes së mjediseve të përshtatshme për transferimin e dy institucioneve të cilat aktualisht, referuar informacionit të autoritetit kontraktor gjenden në mjediset e objektit i cili do ti nënshtrohet rikonstruksionit konkretisht institucioni i Prefektit të Qytetit dhe Këshilli i Qarkut. Gjithashtu, referuar informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka argumentuar se nga ana e Këshillit Bashkiak paraprakisht nuk është miratuar dhënia në përdorim e ish shtëpisë së ushtrisë dy institucioneve të sipërcituar. Gjithashtu, KPP konstaton se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka argumentuar se me anë të Vendimit nr. 193 datë 15.03.2017 i Këshillit të Ministrave “Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 152, Datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për Kalimin në Pronësi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Bashkia Korçë, të Disa Mjediseve të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me Vendndodhje në Bulevardin ‘Republika’”, dhe për Kalimin në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Mjediseve të Katit të Parë Teknik, të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera rezulton se në Vendimit nr. 193 datë 15.03.2017 i Këshillit të Ministrave “Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 152, Datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për Kalimin në Pronësi, nga Ministria E Arsimit dhe Sportit të Bashkia Korçë, të Disa Mjediseve të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me Vendndodhje në Bulevardin ‘Republika’”, dhe për Kalimin në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë Së Punëve të Brendshme, të Mjediseve të Katit të Parë Teknik, të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve” është vendosur:

1. Revokimin e së drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me sipërfaqe ndërtimi 348 (treqind e dyzet e tetë) m² dhe heqjen e këtyre mjediseve nga formulari që i bashkëlidhet vendimit nr. 152, datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave.
2. Mjediset e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Bashkia Korçë dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.”

III.1.2. Në nenin 28 pika 2 të Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i

ndryshuar” parashikohet se “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;

III.1.3. Në lidhje me situatën e mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një rregullim të posaçëm mbi anulimin e procedurave të prokurimit publik parashikohet nga neni 24 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në të cilin në pikën 1 parashikohet se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik; b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore; c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë; ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit; d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar; dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji. Në rastin konkret në arsyetimin e vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashtruar argumente se ndodhemi para rastit të parashikimit të nenit 24 pika 1 gërma “a” të *lex specialis*, për shkak të pa mundësisë së krijuar si me mungesën e vendimit të Këshillit Bashkiak gjithashtu edhe me anë të situatës së re të krijuar pas miratimit të Vendimit nr.193 datë 15.03.2017 i Këshillit të Ministrave.

III.1.4. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në interpretim teleologjik (nga greqishtja *teleo qëllim, logos – studim*) si një prej metodave të interpretimit ligjor mbi nxjerrjen e qëllimit të normës juridike, të nenit 24 pika 1 gërma “a” të *lex specialis*, KPP gjykon se qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret lidhet drejtpërdrejtë me diskrecionin e autoritetit kontraktor mbi anulimin e procedurave të prokurimit publik në ato raste të cilat, autoriteti kontraktor ndodhet para pamundësisë për vijimin e procedurës së prokurimit dhe për shkaqe të cilat dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit. KPP gjykon se në rastin konkret, shkak i pretenduar se në momentin në fjalë është e pamundur sistemimi në mjedise të tjera të institucioneve që ushtrojnë aktivitet në godinën në fjalë, nuk qëndron dhe nuk përbën një shkak i cili ishte i pa parashikueshëm në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor shfaqet në cilësinë e institucionit përgjegjës për prokurimin e fondeve publik në respekt të nenit 12 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Gjithashtu, KPP gjykon se në cilësinë e pronarit/administruesit të objektit (godina aktuale) e parashikuar për t’u rikonstruktuar në funksion të nevojave të autoritetit kontraktor që në momentin e hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, publikimit të kontratës dhe akoma më tej të realizimit të procedurës së shërbimit të konsulencës nga i njëjti autoritet kontraktor apo institucione të tjera për përfitimin e shërbimit të projektimit të mjediseve të reja autoriteti kontraktor ka qenë në dijeni të faktit të sipërcituar, se në mjediset e

propozuara për tu rikonstruara/ndërtuara ushtrinë veprimtari dhe dy institucione të tjera publike. Në cilësinë e përdoruesit të fondeve publike, autoriteti kontraktor duhet të kishte parashikuar qartësisht që në momentin e parë objektin/objektet e mundshme për sistemimin e administratës e cila ndodhet aktualisht në këto mjedise. Akoma më tej, KPP gjykon se autoriteti kontraktor me qëllim realizimin e synimit të krijimit të “Qendrës së kreativitetit” është angazhuar në tërësi duke angazhuar njëherazi fonde publike për realizimin e synimit të sipërcituar. Konkretisht, në funksion të realizimit të synimit të tij autoriteti kontraktor dhe ose institucione të tjera kanë realizuar parprakisht procedurën konkurrese për përzgjedhjen e studios projektuese e cila ka realizuar edhe projektin final mbi të cilin është zhvilluar dhe procedura e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, nga publikimi i procedurës së prokurimit e në vijim autoriteti kontraktor ka angazhuar dhe fondet e procedurës së prokurimit objekt ankimi në pritje të realizimit të kontratës së mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, KPP gjykon se në nenin 60 të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nxjerrë në zbatim të ligjit të mësipërm, është parashikuar shprehimisht: “Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:- objektin e prokurimit;- fondin e përlllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përlllogaritur,në rastin e kontratave shumëvjeçare;- llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj;- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimi objekt ankimi referuar ligjit për prokurimin publik, duke publikuar dokumentet e procedurës sipas formatit të dokumenteve standard të procedurës së prokurimit miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, pjesë e të cilave është njëherazi edhe vendodhja e objektit. Sa më sipër, KPP gjykon se autoritetet kontraktore në publikimin e procedurave të prokurimit duhet të mbajnë në konsideratë se me publikimin e garës kanë trajtuar njëherazi të gjithë problematikën ligjore mbi godinën/objektin/sheshin e ndërtimit të parashikuar për t’u ndërhyrë dhe nuk mund të anulojnë *ex post* procedurën në tërësi mbi faktorë për të cilët autoriteti kontraktor ka qenë në dijeni në momentin e publikimit të kontratës objekt prokurimi (nevojës për të sistemuar dy institucione të tjera në mjedise të përshtatshme).

III.1.5. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të nënvlerësojë situatën juridike në të cilën ndodhet edhe autoriteti kontraktor, i cili megjithëse shfaq angazhimin për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, por njëherazi deklaroi pamundësinë e sistemimit në mjedise të tjera të dy institucioneve të cilat ndodhen në godinë e parashikuar për t’u rikonstruuar. Në rastin konkret, KPP gjykon të ndalet në dy momente të veçanta, së pari në rast se autoriteti kontraktor ndodhet në pamundësinë e përkohshme për realizimin e kontratës deri në përfundim të zgjidhjes së situatës ligjore, ose në rast se autoriteti kontraktor ndodhet në pamundësinë e përhershme të realizimit të kontratës. Në respekt të testit të sipërcituar, KPP gjen me vend të sqarojë se aktualisht nga ana e autoritetit kontraktor nuk është sjellë asnjë argument bazuar në prova dhe fakte se ky i fundit ndodhet në pamundësinë e përhershme të realizimit të kontratës, por *inter alia* është deklaruar se “Gjatë kësaj kohe janë bërë përpjekjet për të gjetur një ambient të përshtatshëm për institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë por pa sukses”. Në lidhje me parashtrimet e mësipërme, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokument provues mbi deklaratimet e sipërcituara. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet e autoritetit kontraktor se ndodhemi para

ndryshimeve e në aktin nënligjor, KPP konstaton se parashikimet e Vendimit nr. 193 datë 15.03.2017 i Këshillit të Ministrave “Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 152, Datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për Kalimin në Pronësi, nga Ministria E Arsimit dhe Sportit te Bashkia Korçë, të Disa Mjediseve të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me Vendndodhje në Bulevardin ‘Republika’”, dhe për Kalimin në Përgjegjësi Administrimi Ministrisë Së Punëve yë Brendshme, të Mjediseve yë Katit të Parë Teknik, të Pronës me Emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve” lidhen mbi revokimin e së drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me sipërfaqe ndërtimi 348 (treqind e dyzet e tetë) m2 dhe heqjen e këtyre mjediseve nga formulari që i bashkëlidhet vendimit nr. 152, datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si edhe kalimin e tyre në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sa më sipër, vendimi i mësipërm nuk shtrin efektet mbi rregullimin e marrëdhënieve të pronësis/administrimit të një mjedis të ndryshëm nga mjedisi në të cilin është parashikuar zbatimi i projektit mbi krijimin e qendrës së kreativitetit, objekt i procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP nënvizon se, është vetë autoriteti kontraktor organi që planifikon, harton e menaxhon procedurat e prokurimit për llogari të tij, përlllogarit dhe planifikon fondet për zhvillimin e procedurave në çdo fillim viti, dhe është ai përgjegjës për zhvillimin në kohë të procedurave të prokurimit për mbulimin e nevojave të tyre. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anulimi i procedurës së mësipërme të prokurimit, duke mos e argumentuar dhe justifikuar atë bazuar në legjislacionin në fuqi, shkakton tejzgjatje të procedurës së prokurimit në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit që synon të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. *Inter Allia dhe Mutatis Mutandis* në Çështjen nr. Case T-203/96 “Embassy Limousines & Services v European Parliament” të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, paragrafi 85, GJED, ndër të tjera ka arsyetuar se është autoriteti kontraktor përgjegjës për zhvillimin e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit.. Akoma më tej në vendimin e mësipërm GJED është shprehur se : “[...]Një kompani e cila është pjesëmarrëse në procedurën e tenderit dhe për të cilën është gjykuar se duhet të jetë ofertuesi i suksesshëm, tenderuesi duhet të marrë, pa ndonjë vonesë, informacion të të sakta sa i përket tërë procedurës [...]”.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar parashtrimeve të operatorit ekonomik ankimues si edhe atyre të autoritetit kontraktor, në rastin në fjalë nuk ndodhemi në rastin klasik të parashikuar në nenin 24 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar pasi shkaqet e sipërcituara nga autoriteti kontraktor nuk lidhen me pamundësinë e përhershëm të realizimit të kontratës për shkaqe të cilat janë të pa parashikueshme dhe jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor që në momentin e njoftimit të kontratës, por lidhet me shkaqe të përkoshme të cilat bëjnë të pamundur lidhjen e kontratës dhe fillimin e punimeve deri në momentin e ndryshimit të faktit/situatës / shkakut ligjor që pengon palët të nisin zbatimin e kontratës. Në lidhje me këtë çështje, mbi momentin e fillimit të kontratës KPP gjykon se është jashtë kompetencave të tij lëndore të shprehet pasi i përket lirisë kontraktuale mes palëve, por KPP konstaton se referuar parashtrimeve me shkrim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ndër të tjera ka deklaruar se “Për më tepër, ne si ofertues që kemi përgatitur ofertën me vlerë më të ulët të kualifikuar jemi dakord që në

kontratën e sipërmarrjes për këtë objekt të përcaktohet se punimet të fillojnë menjëherë pas lirimit të sheshit të ndërtimit. Pra nuk kemi pretendime për kohën e fillimit.” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin në fjalë nuk ndodhemi para rastit të anulimit të procedurës së prokurimit referuar parashikimit të nenit 24 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, por para rastit të ekzistencës së pengesave të përkohshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, çështje të cilat lidhen me momentin e fillimit të punimeve, për të cilët nuk është kompetencë e organit të shqyrtimit të ankesave, Komisionit të Prokurimit Publik të shprehet mbi themelin e tyre.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Boshnjaku B” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-52120-10-05-2016, me objekt “Qendra e kreativitetit”, me fond limit 113.667.377 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Boshnjaku B” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 737 Protokolli

Datë 13.04.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha